



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odojenje za Opštu Upravu



III. Nr. i prot. 2414 Më Dt. 07.07 2022
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC



RAPORTI JANAR - Qershor 2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

TABELA E PERMBAJTJES

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport _____	3
Letërnjoftimi i shkurtër për Kulturën, Rinin, Sportin në Rahovec _____	3
Aktivitetet e Muajit Janar _____	5
Aktivitetet e Muajit Shkurt _____	Error! Bookmark not defined.
Aktivitetet e Muajit Mars _____	Error! Bookmark not defined.4
Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" _____	22
Palestra Sportive "Mizahir Isma" _____	25

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturore. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe me mbi 33.000 ekzemplarë, si qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovecit janë; festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofest", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në qershor të vitit 2022. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

AKTIVITETET E MUAJIT JANAR

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:


- Vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë.
- Vizitë parqeve në Zatriq, Brestovc, si dhe bibliotekës në Krushë e Madhe.
- Formimi i komisionit për aktivitetin përkujtimor “Flaka e Janarit”.
- Takim njoftues me klubet sportive si dhe shoqëritë kulturore - artistike që veprojnë në Komunën e Rahovecit.
- Takim njoftues me të gjithë operatorët e projekteve që operojnë në DKRS.
- Vizitë punimeve në fushën sportive në fshatin Zoqisht.
- Përfundimi i ndriqimit në shkollën “Bekim Sylka”.
- Homazhe përkujtimore për nder të “Flaka e Janarit” me datë 27.01.2022 në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të vogël. Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në sallën e Kuvendit Komunal, ku vlen të theksohet se u ndan edhe mirënjohje për të plagosurit më 27.01.1990.
- DKRS ka formuar komisionin për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike në kuadër të DKRS-së, në më pak se një vit, me këtë përbërje: z. Luan Danuza, Diellza Qanta dhe Fidan Hoti.
- Kemi bërë sanimin e ndriqimit publik tek fusha e tenisit, gjithashtu kemi bërë pastrimin e shtëpive të kulturës në Drenoc dhe Xërxe, pastrimi i parkut tek shkolla e mesme “Xhelal Hajda” si dhe parkut te shkolla “Bekim Sylka”.
- Në shtëpinë e kulturës në Xërxe kanë filluar punimet për rregullimin e hapësirës për bibliotekë.
- Vizitë punimeve tek shtëpia muze e “Ukshin Hotit” në Krushë të Madhe.
- DKRS në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike ka mbajtur garën shkollore në ping pong.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Për nder të Ditëve Përkujtimore “Flaka e Janarit” është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj dite.



- ❖ Në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit, të rënë përgjatë Janarit të acartë të historisë sonë, në përpjekje të parreshtura për mbrojtje të identitetit, për pavarësi dhe sovranitet të trojeve tona janë mbajtur homazhe në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të vogël.
- ❖ Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në sallën e Kuvendit Komunal, ku vlen të theksohet se u ndan edhe mirënjohje për të plagosurit më 27.01.1990.



- Takim njoftues me shkollat, klubet dhe oqj-të sportive nga Komuna e Rahovecit për aktivitetet të ardhshme dhe mbarvajtjen e tyre.



- Shoqata e pedagogëve të kulturës fizike të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, organizuan garat komunale në ping - pong me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë.



AKTIVITETET E MUAJIT SHKURT

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Takim me MKRS, respektivisht me zyrtarin e departamentit të sportit lidhur me memorandumet e bashkëpunimit të nënshkuara mes MKRS dhe komunës.
- Rregullimi i 120 ulëseve në palestrën sportive "Mizahir Isma".
- Formimi i këshillit organizues për nder të 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës.
- Formimi i grupit punues për hartimin e rregullores për dhënien e dekoratave, mirënjohjeve dhe medaljeve nga Komuna e Rahovecit.
- Vizitë monumenteve historike në Rahovec.
- Takim me grupin punues për hartimin e rregullores për dhënien e titujve të nderit, si: dekoratat, mirënjohjet, medaljet dhe tituj të tjerë nga Komuna e Rahovecit.
- Pastrimi i Shtëpisë së Kulturës në Krushë të Madhe dhe Ratkoc si brenda dhe jashtë hapësirave të objekteve.
- Janë duke u kryer punimet në Shtëpinë e Kulturës në Xërxë për hapësirën e bibliotekës.
- Është bërë sanimi i problemit me rrymë që kemi patur në zhveshtoret e palestrës sportive.
- Takim me operatorin e kompanisë "Bamirësi" dhe dakordimi që me datën 01 - 02 Mars të fillojnë punimet në Dejnë.
- Me datë 11.02.2022 kemi filluar punimet për rregullimin e fushës sportive në Reti të Poshtme.
- Me datë 12.02.2022 kanë filluar aktivitetin sportiv në Futboll të Vogël - Futsall, sipas agjendës së këshillit organizues për nder të 14 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ku po marrin pjesë 20 ekipe të komunës sonë.
- Kanë përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e parapara për nder të 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- Pastrimi i hapësirës së jashtme - oborrit të Shtëpisë së Kulturës në Krushë të Madhe.
- Është bërë përrurimi i fushës sportive në Zaqisht.
- Kanë filluar punimet për rregullimin e fushës sportive në Reti të Epërme.
- Kemi inspektuar punimet ku është duke u bërë rregullimi i fushës sportive në Reti të poshtme, punimet janë duke shkuar mirë dhe janë në fazën përfundimtare.

- Takimi i radhës me grupin punues për hartimin e rregullores për dhënien e titujve dhe dekoratave në komunën e Rahovecit.
- Me datë 25.02.2022 kanë filluar punimet për rregullimin e fushës sportive në Celinë.
- Me datë 26.02.2022 kanë filluar punimet në Dejnë, vazhdim i punimeve ku do të bëhet rregullimi i hapësirës sipas projektit ku mbahet festivali “Anadrinia Jehon”.
- Takim me operatorët dhe dakordimi për fillimin e punimeve nga data 02.03.2022, si: fillimin e punimeve për Aneksin tek shtëpia e kulturës në Krushë të Madhe, parkun mbrapa stacionit të autobusave ne Rahovec, si dhe të bëhet riparimi i parkut në Zatriq.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj dite.



- ❖ Në takim, këshilli organizues shqyrtoi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin sa më të mirë të kësaj ngjarje historike, ku u diskutuan idetë dhe aktivitetet që do të organizohen për nder të 17 Shkurtit Ditës e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- ❖ Janë mbajtur homazhe në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec.
- ❖ Është organizuar aktivitete kulturore, përkujtimore e sportive “Turneu i Pavarësisë”, në këtë organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë mbajtur gara në disa disiplina të sportit: futboll në sallë, volejboll (për femra - kl. XII) dhe shah.



- ❖ Është bërë përrurimi i monografisë “Yjet e Lirisë”, të autorit Sadik Krasniqi, nën patronazhin e kryetarit të komunës së Rahovecit Smajl Latifi,
- ❖ Aktivitetet përkujtimore, kulturore e sportive në kuadër të shënimit të 14-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u përmbyllën me manifestimi qendror i cili u mbajt në qendrën e kulturës “Mensur Zyeraj”.
- ❖ Manifestimet në shënim të 14-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u pasuruan edhe me një ekspozitë të artistëve figurativ të Rahovecit, të organizuar në shoqatën “Art Studio”. Në këtë ekspozitë kolektive u shpalosën punimet e artistëve të Rahovecit, ku dominonte motivi atdhetar.





- Kanë filluar ndërtimet e fushave sportive në fshatrat Reti të Epërme dhe ne Celin, në kuadër të realizimit të projekteve, e në veçanti në kuadër të ndërtimit të fushave sportive në komunën e Rahovecit.

Komuna e Rahovecit është e përkushtuar për të krijuar kushte sa më të mira për të rinjtë dhe sportistët e komunës së Rahovecit, ndërtimi i infrastrukturës sportive për të rinjtë është ndër objektivat që po përmbushen në vazhdimësi.



- Është takim me të rinjtë e Komunës së Rahovecit në Qendrën Rinore "SHL-Kosova", në takim është diskutuar për qështje të ndryshme, si aktivitetet e përbashkëta, trajnimet, debatet e aktivitetet të lira për të rinjtë e Rahovecit. Drejtorja për Kulturë, Rinisë dhe Sport ka si mision fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje te të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.



- Është përfuruar fusha sportive në fshatin Zoqishtë, në kuadër të projektit "Regullimi i terreneve Sportive", ky investim është bërë nga Komuna e Rahovecit.



❖ Kjo fushë do të shërbejë si pikë argëtimi, posaçërisht për nxënësit e mësimdhënësit e shkollës si dhe rininë e fshatit të cilët do mund të zhvillojnë aktivitetet të ndryshme sportive në futboll, basketboll, hendboll dhe volejbol.

❖ Me ndërtimin e terreneve të reja sportive, Komuna e Rahovecit synon promovimin e sportit, jetesës aktive dhe të shëndetshme, angazhimin e të rinjve me aktivitet fizik, si dhe konkurrencën e shëndetshme të garës.

AKTIVITETET E MUAJIT MARS

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Kompania "BAMIRSI" me datë 26.02.2022, ka filluar punimet në Dejnë, ku është përfunduar drenazhimi, është duke u bërë rregullimi i kubëzave, shkallët, rregullimi i hapësirës sipas projektit, ku edhe mbahet festivali "Anadinia Jehon".
- Kemi inspektuar punimet ku është duke u bërë rregullimi i fushës sportive në Reti të poshtme.
- Kemi takuar operatorin "NBT-Ing" dhe jemi dakorduar që punimet të rifillojnë në Krushë të Madhe në projektin Muzeu "UKSHIN HOTI" me datë: 07.03.2022.
- Është bërë sanimi i ndriqimit tek fusha e Tenisit ku kishte probleme.
- Me datë 04.03.2022 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë.
- Në bashkëpunim me OVL-UÇK-në po mbahen aktivitetet e 5, 6 dhe 7 Marsit - Epopeja e UÇK-së.
- Punimet janë duke vazhduar në Dejnë në rregullimin e amfiteatrit.
- Në Gradish tek obelisku, jemi duke u marrë me kompaninë "EKODRINIA" për sanimin e qatisë së kullës, e cila ka probleme gjatë reshjeve, duhet të bëhet izolimi i qatisë, si dhe rregullimin e ndriqimit ku duhet të zëvendësohen të gjithë poqat elektrik.
- Nga java e kaluar kanë rifilluar punimet tek Muzeu "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe.
- Kemi mbajtur takim me të gjitha klubet sportive të cilat zhvillojnë aktivitetet sportive në Palestrën "Mizahir Isma", ku në takim është diskutuar që të zbatohet rregullorja për palestrën sportive.
- Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e OVL-UÇK-së, për organizimin e aktiviteteve përkujtimore që fillojnë nga data 25 mars, ku dhe do të bëhet agjenda për homazhe nga data 25 Mars - 02 Prill.
- Gjatë kësaj jave kanë filluar punimet në rregullimin e parkut dhe parkingut tek stacioni i autobusave.
- Vizita në të gjitha vendbanimet ku janë duke u kryer punët të cilat janë në kuadër të DKRS-së.
- Në Gradish te obelisku janë sanuar problemet e qatisë ku ka patur problem me ujin atmosferik, si dhe është bërë rregullimi i ndriqimit publik ku ka patur probleme nga kompania "EKODRINIA".
- Punimet tek shtëpia muze "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe janë duke vazhduar, brenda kësaj jave përfundohen muret e objektit dhe bëhet përgaditja e pllakës për katin e parë.
- Së bashku me përfaqësuesit e OVL-UÇK-s dhe me nënkryetarin, me datë 16.03.2022, kemi mbajtur takim me kryetarët e këshillave lokale për organizimin e aktiviteteve përkujtimore



që fillojnë nga data 25 Mars deri më 02 Prill, ku do të bëhen homazhe në të gjitha vendbanimet, agjenda publikohet sot me 21 Mars.

- Me datë 14.03.2022, kanë filluar punimet në rregullimin e parkut dhe parkingjeve prapa stacionit të autobusëve, punimet janë duke vazhduar.
- Punimet janë duke vazhduar edhe në Dejnë në rregullimin e amfiteatrit.
- Punimet tek shtëpia muze “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe janë duke vazhduar.
- Punimet janë duke vazhduar në Dejnë në rregullimin e amfiteatrit.
- Punimet në rregullimin e fushës sportive në Celinë janë duke vazhduar, ku ka përfunduar pjesa e jashtme - themelet, janë vendosur shtyllat e hekurit ku bëhet më pastaj rrethoja me rretë, gjatë kësaj jave do të bëhet mbushja e fushës me zhavor.
- Punimet në rregullimin e parkut dhe parkingjeve mbrapa stacionit të autobusëve janë duke vazhduar, është bërë përgaditja e hapësirës për vendosjen e kubëzave sipas projektit.
- Në bibliotekën komunale “Sylejman Krasniqi” me datë 21.03.2022 është mbajtur aktivitet për ditën e Poezisë, dhe kemi pranuar disa libra nga autorët: Hysen Berisha, Shani Hoti, Valbona Hoti dhe Hazir Luta.
- Janë mbajtur aktivitetet përkujtimore me 25-26 Mars në Brestoc, Fortesë, Celinë dhe Krushë të Madhe, dhe do të vazhdojnë deri më 02 Prill sipas agjendës.
- Është formuar këshilli organizues për edicionin e 21-të i Festivalit Folklorik “Anadrintia Jehon” 2022.
- Thirrja për subvencionimin e OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport është shtyer deri me datë 01.04.2022, pasi që kemi pasur shumë kërkesa për aplikim.

Disa nga aktivitetet kyçe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Në fshatin Dejnë janë duke vazhduar punimet në infrastrukturën e amfiteatrit të festivalit “Anadrintia Jehon”.
 - ❖ Në hapësirat e tij, amfiteatri është i pajisur edhe me skenën, podiumin, dhomat e zhveshjes së artistëve, gjithashtu edhe me ndriçim publik.
 - ❖ Një amfiteatër natyror është një hapësirë e performancës, e vendosur në një vend ku një ambient i pjerrtë bënë jehonë, duke e bërë atë ideal për shfaqje muzikore dhe teatrale.
 - ❖ Amfiteatri i festivalit “Anadrintia Jehon”, do të shërbejë për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë mbarëkombëtare, duke përzgjedhur në të krijimet më autentike e më të lashta që populli shqiptarë ka krijuar ndër shekuj.

- ❖ Ky objekt kulturor do të synojë gjallërimin e jetës kulturore të vendit në përgjithësi si dhe të komunës së Rahovecit, që si rajon është i pasur me trashëgimi kulturore, duke përcjellë tek spektatorët dhe vizitorët vendas dhe të huaj, kulturën popullore që ruhet dhe kultivohet në hapësirat mbarëkombëtare.



- Është publikuar thirrja për mbështetjen financiare publike për financimin e projekt propozimeve të, Klubeve, Shoqatave dhe OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve sportive.
- ❖ Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjithve, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport, në Komunën e Rahovecit.

- Është publikuar thirrja për mbështetjen financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, shoqatave për organizimin e aktiviteteve Kulture e rinore.
- ❖ Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjitha, OJQ-ve, Shoqatave të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e kulturës dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të DKRS-së, në Komunën e Rahovecit.
- Në kuadër të ditëve të Epopes së UÇK-së” për tri ditë me radhë me datë 5,6,7 Mars e kujtojuam dhe nderuam të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një ëndërr që është bartur tek ne brez pas brezi - Lirinë!



- Është bërë ndriqimi i obiliskut në Kompleksin memorial të dëshmorëve në Gradish.



- Qeveria Japoneze përmes mbështetjes së marrë në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social, të administruar nga Banka Botërore e që realizohet në bashkëpunim me MAPL dhe CDF, do mbështesë të rinjtë nga Komuna e Rahovecit.

- ❖ Përmes kësaj mbështetje Rahoveci është një nga 10 komunat përfituese, andaj të gjithë të rinjtë e grupmoshave 15 - 24 vjeç, kanë mundësinë të aplikojnë për grante që variojnë nga 1000 - 15.000 \$ me projekte që synojnë të përmirësojnë përfshirjen socio-ekonomike të të rinjve.

- ❖ Mbështetja për të rinjtë është pikënisja e së mbarës, të cilën vazhdueshëm e kemi ofruar dhe do ta ofrojmë, pa mëdyshje!





➤ Në Biblioteken Komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec u përrua Këndi Arkivor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë.

- ❖ Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.
- ❖ Ky kënd do t’iu mundësojë studiuesve dhe hulumtuesve shkencor që të kenë qasje në dokumentet arkivore nga Rahoveci, pa pasur nevojë të shkojnë në Tiranë apo Prishtinë.
- ❖ Këndi Arkivor u hap me kontributin e DKRS-së në Bibliotekën Komunale “Sulejman Krasniqi” dhe aty do të kenë qasje të gjithë ata që dëshirojnë të marrin dokumente dhe të dhëna arkivore, qoftë në Tiranë apo në Prishtinë.





- Ka filluar ndërtimit të parkut te stacioni i autobusave në Rahovec në kuadër të projektit “Ndërtimi i parqeve dhe këndëve rekreative për fëmijë”.
- ❖ Shtimi i hapësirave të gjelbëruara është një nga prioritetet e Komunës së Rahovecit, duke mundësuar kështu që qytetarët të pushojnë dhe kalojnë kohë më shumë në mjedis të hapur.



➤ Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi orë letrare me krijues dhe nxënës të shkollave të mesme e fillore të Rahovecit.

- ❖ Me këtë rast drejtori i DKRS-së Afrim Dina falënderoi poetët për bashkëpunimin dhe i siguroi se kjo drejtori edhe në të ardhmen do të vazhdojë të mbështesë në forma të ndryshme krijimtarinë letrare.
- ❖ Zyrtari i DKRS-së Qemajl Krasniqi foli për rolin e poezisë në tërësinë e krijimeve letrare, ndërsa lidhur me ndërlidhjen e krijimtarisë gojore dhe poezisë, një vështrim kronologjik e bëri Prof. Dr. Sabahajdin Cena.
- ❖ E krijuesit Blerta Nalli-Gashi, Hazir Luta, Milazim Bajraj, Hysen Berisha, Valbona Hoti dhe disa krijues të rinj, paraqitën disa krijime artistike të tyre dhe të autorëve të ndryshëm.
- ❖ Në këtë ceremoni disa nga krijuesit i dhuruan përmbledhje me poezi e romane Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, dhurata që i pranoi drejtori Afrim Dina.



AKTIVITETET MUAJI PRILL

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Janë mbajtur aktivitetet përkujtimore në të gjitha vendbanimet nga data 25.03.2022 deri me datë 02.04.2022.
- Është mbajtur takimi i parë me këshillin organizues për përgaditjen dhe mbarëvajtjen e Festivalit Folklorik "Anadrinia Jehon".
- Draft rregullorja për dhënien e titujve dhe dekoratave nga data 28.03.2022 është në konsultim publik deri me datë 28.04.2022, ku gjatë kësaj kohe presim edhe komente nga qytetarët, me datë 12.04.2022 është caktuar debat publik në sallën e kuvendit.
- Është mbajtur takim me përfaqësuesit e OVL-UÇK –së për aktivitetet përkujtimore që fillojnë nga data 12,13,18, dhe 26 Prill, në nderim të dëshmorëve: Pataçan, Krushë të Madhe, Zatriq-Ratkoc dhe Drenoc.
- Kemi bërë vizita në të gjitha vendpunishtet ku janë duke u kryer punimet, mirpo gjatë kësaj jave për shkak të kohës që ka qenë me shi nuk është punuar, presim që të fillojn gjatë kësaj jave me rregullimin e kohës.
- Kemi prapë probleme tek obelisku, edhe pse e kemi sanuar problemin pak më herët, me përfaqësuesin e "Ekodrinia" jemi duke u marr për sanimin e problemit.
- Thirrja për subvencionimin e OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport ka përfunduar me datë: 01.04.2022, komisionet janë formuar për vlerësimin e të gjitha aplikacioneve dhe në ditë në vijim do të fillon edhe shqyrtimi i tyre ku i kemi 32 aplikacione të regjistruara si OJQ në komunën tonë.
- Me datë 12.04.2022 është mbajtur konsultimi publik me qytetar në sallën e Kuvendit Komunal për draft rregulloren e dhënive të titujve dhe dekoratave në Komunën e Rahovecit .
- Në bashkëpunim me përfaqësuesit e OVL-UÇK –së në nderim të dëshmorëve janë duke u mbajtur aktivitetet përkujtimore nga data: 12,13,18, dhe përfundojnë më 26 Prill në Drenoc.
- Kemi bërë vizita në të gjitha vendpunishtet ku aktualisht janë duke u kryer punimet në Dejn në rregullimin e amfiteatrit dhe në Celinë, rregullimi i fushës sportive.
- Komisionet për subvencionimin e OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport me datë: 15.04.2022 i kanë shqyrtuar dhe verifikuar të gjitha aplikimet e OJQ-ve ku gjithësej kishin aplikuar 33 OJQ, për mos kompletim të dokumentacionit sipas kritereve në thirrjen publike nga DKRS është refuzuar një (1) aplikacion.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Me rastin e Ditës Botërore të Librit dhe të drejtës autoriale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Rahovec organizon aktivitete
 - ❖ Takime me krijues dhe promovim të veprave letrare.
 - ❖ Më 22 prill 2022 në orën 11:00 do të organizohet një bashkëbisedim me shkrimtarin dhe hulumtesin shkencor Fari Xharra.
 - ❖ Aktivitetet janë mbajtur në lokalet e qendrës rinore SHL Kosova dhe janë organizuar në bashkëpunim me Klubin e Karrierës të shkollës së mesme "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec.
 - ❖ Në Qendrën e Kulturës "Mensur Zyberaj" është bërë promovimi i monografisë "Për të gjallë kullat nuk i lëshojmë", kushtuar dëshmorit të kombit SADEDIN HASANI, shkruar nga Gëzim Ajgeraj.



- Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Tokës e cila shënohet në të gjithë botën përmes aktiviteve të shumta që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin qytetar ndaj çështjeve mjedisore.



- ❖ Përmes punëve vullnetare, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me drejtorit Arsimi, drejtirinë e Shërbimeve Publike dhe të Urbanizmit zhvilluan aktivitete të shumta në pastrimin, rregullimin dhe mbjelljen luleve dhe fidaneve në hapsirat e qytetit të Rahovecit.

- Qeveria Japoneze përmes mbështetjes së marrë në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social, të administruar nga Banka Botërore e që realizohet në bashkëpunim me MAPL dhe CDF ka mbështetur të rinjtë përmes projektit “Komuna për të rinjtë”.

- ❖ Andaj të gjithë të rinjtë e grupmoshave 15-18 vlera e përfitimit të grantit nga 1000 US\$ - 4000 US\$ kurse, 18 - 24 vjeç, kishin mundësi të aplikojnë për grante që variojnë nga 6000 US\$ - 15.000 US\$, me projekte që synojnë të përmirësojnë përfshirjen socio-ekonomike të të rinjve.



- Më 23 prill 2022 në shënim të Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtës Autoriale, në mjediset e Qendrës Kulturore “Mensur Zyberaj” në Rahovec u bë promovimi i monografisë “Për të gjallë kullat nuk i lëshojmë”, kushtuar dëshmorit të kombit Sadedin Hasani.



- Kryetari komunës z. Smajl Latifi së bashku me nën kryetarin z. Fatmir Iska dhe drejtorin e DKRS-së z. Afrim Dina, kanë inspektuar sot fillimin e punimeve në rregullimin e fushës sportive të shkollës së mesme profesionale “Selajdin Mullabazi- Mici” në Rahovec

- ❖ Me këtë rast vlen të theksohet se ky projekt është vazhdimësi e projektit që parasheh ndërtimin dhe rregullimin e terreneve sportive në Komunën e Rahovecit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



AKTIVITETET E MUAJIT MAJ

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Në bashkëpunim me përfaqësuesit e OVL-UÇK –së për Javën e Dëshmorëve kanë filluar aktivitete me datë 05.05.2022. ku kemi bërë homazhe tekë varrezat e Dëshmorëve në Rahovec, si dhe është mbajtur turne në futboll, këto aktivitete do të vazhdojn sipas agjendës.
- Kemi bërë vizita në të gjitha vendpunishtet, punimet në **Dejn** në rregullimin e amfiteatrit ku kan përfunduar punimet dhe me datë 11.05.2022 bëhet përirimi i Amfiteatrit, në Celinë është përfunduar shtresa e fundit me zhavor në rregullimin e fushës sportive, në Rahovec tekë shkolla profesionale është duke u rregullimi i fushes sportive,
- Gjatë kësaj jave kompania ka filluar pastrimin e shtëpive të kulturave si Drenoc, Xërrxe dhe pastimi i parqeve që janë në menagjim të DKRS-s.
- Punimet tekë muzeu Ukshin Hoti janë duke vazhduar sipas projektit nga operatori.
- Me datë 06.05.2022 është bërë nënshkrimi i kontratave me të gjithë përfituesit e OJQ-ve sipas thirrjes publike nga DKRS për subvencionim në Kulturë, Rini dhe Sport.
- Në bashkëpunim me përfaqësuesit e OVL-UÇK –së për Javën e Dëshmorëve janë mbajtur aktivitete nga data: 05.05.2022 deri me datë: 12.05.2022. ku kemi bërë homazhe tekë varrezat e Dëshmorëve në Rahovec, Pastasel, Vrajakë, Ratkoc si dhe manifestimi qendrorë në Gradish.
- Me datë: 11.05.2022 është bërë përirimi i amfiteatrit ne **Dejn**, ku pas përirimit ka filluar edhe Festivali **Anadriinia Jehon 2022**, ka vazhduar për tri ditë rreshtë dhe është përmbyllur me datë: 13.05.2022, pjesëmarrës në Festival kanë qenë gjithësej 22 grupe nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kalabria.
- Në Rahovec tekë shkolla profesionale është bërë përirimi i fushës sportive me datë: 14.05.2022, Celinë është përfunduar shtresa e fundit me zhavor në rregullimin e fushës sportive, dhe gjatë ditëve në vijim do të bëhet asfaltimi i fushës në Celinë dhe Reti të Poshtëme.
- Gjatë kësaj jave kompania ka filluar pastrimin e shtëpive të kulturave si Drenoc, Xërrxe dhe pastimi i parqeve që janë në menagjim të DKRS-s.
- Punimet tekë muzeu Ukshin Hoti janë duke vazhduar sipas projektit nga operatori.
- Me datë: 16.05.2022 është mbaj aktivitet tekë shtëpia muze e **Ukshin Hotit**, në shënimin e ditës së marrjes nga burgu.
- Me datë 18.05.2022 në Prishtinë është shenuar dita botrore e Muzeut, ne si DKRS kemi marrë pjesë me disa nxënës të shkollave të mesme në Muzeun e Bibliotekës kombëtare Hivzi Sulejmani.
- Punimet tekë muzeu **Ukshin Hoti** janë duke vazhduar sipas projektit nga operatori, është bër mbushja e pllakës, tani është duke u bërë pregaditjet për mbushjen e pllakës tjetër
- Punimet tekë **Kompleksi Sportiv** rifillojnë sot me datë 23.05.2022.
- Është duke u bërë pastrimi i shtëpive të kulturave si Drenoc, Xërrxe si dhe pastimi i parqeve që janë në menagjim të DKRS-s.

- Në bashkëpunim me Organizatën OVL-UÇK-n, agjenda e aktiviteteve dhe homazheve për muajin Maj 2022 publikohet sotë me datë 23,05,2022
- Aktivitet nga DKRS në bashkëpunim me OVL-UÇK-n janë bërë homazhe në nderim të Dëshmorëve duke filluar nga data 26, 27, 28 Maj 2022si dhe me datë 28.05.2022 në shtëpin e kulturës “Mensur Zyberaj” është shenuar dita e shtëpis së kulturës.
- Me datë 30.05.2022 fillojnë punimet për rregullimin e fushës sportive në fshatin Gexhe
- Punimet tekë muzeu Ukshin Hoti janë duke vazhduar sipas projektit nga operatori, tani është duke u bërë pregaditja për mbushjen e pllakës tjetër.
- Është duke u bërë pastrimi i shtëpive të kulturave si Drenoc, Xërrxe si dhe pastimi i parqeve që janë në menagjim të DKRS-s.
- Në shtëpin muze “Ukshin Hoti” janë vendosur shtyllat dhe Flamujt, si dhe janë duke u bërë pregaditjet për aktiviteni i cili do të mbahet më 17 Qershor.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Takimi i këshillit organizues të festivalit Anadrinia Jehon 2022, gjatë këtij takimi këshilli organizues shqyrtoi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizimin e edicionit të 21-të, të festivalit Anadrinia Jehon që mbahet në fshatin Dejnë, ku u diskutuan të arriturat e deri tanishme të organizimit, konfirmimi i grupeve pjesëmarrëse, u ndanë përgjegjësitë dhe u morë vendimi për anëtarët e jurisë profesionale.



- 28 organizata joqeveritare, rinore, sportive dhe kulturore, që veprojnë në komunën e Rahovecit, përfituan subvencionim direkt nga Komuna e Rahovecit.
 - ❖ Drejtoria e Kulturës, Rinis dhe Sportit ju dha përkrahjen e merituar për t'i mbështetur projektet e tyre, që burojnë nga shkathtësitë e tyre në fusha të ndryshme. Vlera e përkrahjes për këto OJQ përfituese nga Komuna e Rahovecit për këtë vit është 121,500.00 €.




- Përrurimi i fushës sportive tek Shkolla e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici" në Rahovec!
 - ❖ Kjo fushë do ju shërbej nxënësve të kësaj shkolle të cilët tanimë kanë një fushë sportive moderne ku mund t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre.



➤ Me sukses është përmbyllur edhe një edicion të festivalit të folklorit Anadriina Jehon

- ❖ Ecuria e mirë e edicionit të njëzetënjëtë të festivalit Anadriina Jehon dëshmoi për punën dhe përkushtimin e Këshillit Organizues, banorëve të fshatit Dejnë, strukturave të pushtetit lokal dhe pjesëmarrësve në këtë festival.
- ❖ Ky edicion tregoi se ky aktivitet kulturor, me karakter kombëtar, është konsoliduar tashmë dhe ka vënë themele të forta.
- ❖ Pjesëmarrja e njëzet e dy grupeve artistike nga vise të ndryshme shqiptare dhe nga mërgata, është dëshmi e kësaj. E veçanta e këtij edicioni ishte prania e grupit artistik arbëresh "Gjaku i Arbërit" nga Kalabria.
- ❖ Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi priti me kënaqësi në zyrë këtë grup të drejtuar nga Mikele Greko, shoqëruar nga nënkryetarja arbëreshe e komunës San Martino di Finita, zonjën Ilari Likursi, me të cilët shkëmbyen dhurata simbolike. Ishte shumë emocionues fakti se këta entuziastë të kulturës popullore, të cilët edhe pas gjashtëqind vjetësh ende komunikojnë në shipen arkaike. Programi i tyre në skenën madhështore të festivalit Anadriina Jehon u prit me entuziazëm dhe me duartroktije të vazhdueshme të publikut të shumtë në numër. Prandaj edhe çmimi "Mirënjohje e veçantë" për këtë grup ishte më se i merituar.





➤ Në shënim të Ditës Botërore të Muzeve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, respektivisht sektori për Rininë, organizoi një vizitë në Qendrën e Dokumentimit të Fondit për të Drejtën Humanitare, e hapur në mjediset e bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë.

- ❖ Nxënësit e shkollave të mesme "Xhelal Hajda-Toni" dhe "Selajdin Mullabazi-Mici", patën rastin të informohen nga Bekim Blakaj, drejtor ekzekutiv i Fondit për të Drejtën Humanitare-Kosovë, rreth punës dhe misionit të kësaj organizate për dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë.



➤ Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec 28 maj 2022

- ❖ Me aktivitete të shumta është shënuar Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec, në aktivitete pjesëmarrës ishin kryetari i komunës z. Smajl Latifi, zyrtarë komunalë, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve.
- ❖ Aktivitetet kanë filluar me homazhe dhe nderime të pllaka përkujtimore e heronjve dhe dëshmorëve të kombit dhe është bërë prezantimi i aktiviteteve dhe sukseset e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport nga janari e deri më tani.
- ❖ Aktivitetet në qendrën kulturore "Mensur Zyberaj" janë mbyllur me një program artistik të përgaditur nga Shoqëria Kulturore Artistike "Bajram Curri" nga Krusha e Madhe.



➤ **Më 30.05.2022 kanë filluar punimet në rregullimin e fushës sportive në fshatin Gexhe**

- ❖ Në praninë e bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve të Gexhës, u vunë themelet e projektit më të ri, që do t'u shërbejë qëllimeve dhe nevojave për aktivitete sportive të gjithëve, pa dallim.
- ❖ Kryetari i Komunës si dhe DKRS, jemi të përkushtuar, posaçërisht për të rinjtë, duke krijuar dhjetëra projekte që ndihmojnë aktivitete kulturore, rekreative dhe sportive, në mënyrë që talentet dhe energjitë rinore të mos ndrydhen, por të shprehen e zhvillohen.



AKTIVITETET E MUAJIT QERSHOR

Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:


- Me datë 1 Qershor në shenimin e ditës nderkombetare të fëmijëve DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-n dhe shoqaten "HAREJA" kemi mbajtur aktivitet me fëmijë në shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj".
- Aktiviteti nga DKRS me 03 Qershor në zbulimin e Bustit të Heroit Skënder Rexhepi në Mrasor si dhe me 04 Qershor në Ratkoc homazhe për deshmorin Naser Krasniqi dhe promovimi i librit i autorit Sadik Krasniqi
- Me datë 04.06.2022 është bërë vendosja e Panellave Solar në palestren sportive "Mizahir Isma".
- Është formuar keshilli organizues për nderë të ditës së Çlirimit që do të mbahet me 14 Qershor.
- Po vazhdojn punimet tekë shtëpia Muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe.
- Agjenda e aktiviteteve për ditën e çlirimit me datë 14 Qershor, është bërë publike me datë 10.06.2022.
- Është formuar keshilli organizues për 17 Qershor, ditëlindja e Ukshin Hotit, me datë: 09.06.2022 është mbajtur takimi i parë.
- Me datë 06.06.2022 kanë filluar punimet në rregullimin e parkut tek Maja e Shkodranit.
- Po vazhdojn punimet tekë shtëpia Muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapsirave publike, tereneve sportive dhe parqet të cilat janë në kuadër të DKRS-s po vazhdojn.

Disa nga aktivitetet kyqe të zhvilluara gjatë këtij muaji:

- Me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve -1 Qershorin, në bashkëpunim me DKA dhe shoqatën "Hareja" në Rahovec është organizuar program festiv për fëmijë.
 - ❖ Aktivitetet fëmijëve filluan me vizitën e tyre tek kryetari i komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi, pastaj vazhduan me defilim nga shoqata "Hareja" deri tek shtëpia e Kulturës "Mensur Zyberaj" ku edhe shfaqën një program të pasur me këngë, valle, skeqe dhe poezi të përgaditur nga mësueset e Harejës dhe mësueset e katër shkollave fillore të qytetit.



- Në palestrën "Mizahir Isma" është bërë vendosja e Panelave Solare, me ç'rast kjo do të ndikoj në uljen dhe kursimin e shpenzimeve të rrymës elektrike



- Në kuadër të manifestimit për Ditën e Çlirimit të Rahovecit, më 14 qershor, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

- ❖ Homazhe tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec;
- ❖ Me nxënësit e klasave të dhjeta të SHML "Xhelal Hajda - Toni" është mbajtur një ekspozitë me punimet e tyre të bukura në picture, e veçanta e këtyre punimeve ishte se të gjitha ishin piktura të punuara në pëlhurë.



Kjo ekspozitë u vizitua edhe nga kryetari i komunës, drejtorë të drejtorive komunale dhe nga shumë qytetarë, të cilët u kënaqën duke parë këto punime të bukura artistike të nxënësve;

- ❖ Aktivitetet kanë vazhduar me koncertin festiv me këngëtarët e estradës të Komunës së Rahovecit.



BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI” - RAHOVEC

Përgaditja e raporteve mujore dhe vjetore

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënies, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexueshmërisë. Biblioteka në tërsi ka ruajtur yzshdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë pasur nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

Aktivitetet për muaj Janar-Qershor

- Nxënësit e klasës së X dhe XII-të të SHMPL - “Selajdin Mullabazi- Mici” të shoqëruara nga mësimdhënëset Znj.Shkëndije Popaj dhe Znj. Anita Gashi - Kadiri në mënyrë të organizuar vizituan bibliotekën “Sulejman Krasniqi” - Rahovec. Ata njoftuan për së afërmi me fondin e librave për fëmijë dhe të rritur, me hapësirat e rehatëshme për lexim si dhe rreth regjistrimit dhe huazimit të librit.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës nga autori Mazllum Baraliu me 8 ekzemplar të librit me titull: “Tribunë dhe Korifenj”, si dhe me 3 ekzemplar nga autori Shemsi Krasniqi me titull: “Arti Shkëmbor i Kosovës”.
- Është bërë pasurimi i bibliotekës nga autori Sali Bytyqi me 5 ekzemplar të librit me titull: “Antalogji poetike” si dhe 5 ekzemplar nga autori Bajram Bekteshi me titull: “Bulbëri mendimesh”.
- Biblioteka “Ibrahim Rugova”- Gjakovë ia dhuroi bibliotekës sonë 1 ekzemplar të autorës Samile Rasim Doli, me titull: “Historiku i Shkollës së Mesme Ekonomike Kadri Kusari-Dushi në Gjakovë”- prej vitit shkollor 1990/91 deri në vitin 1998/99.
- Me datë: 08.03.2022 - Në Bibliotekën Komunale “Sulejman Krasniqi”- në Rahovec u përrua Këndi Arkivor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë. Në këtë përrim morën pjesë: Kryetari i Komunës së Rahovecit Smajl Latifi, Drejtori i Drejtorisë së Arkivave të Shqipërisë Dr. Ardit Bido, Kryeshefi Ekzekutiv të ASHAK-së Mr. Bedri Zyberaj si dhe z. Afrim Dina së bashku me stafin e DKRS-së. Hapja e këtij Këndit Arkivor

do t'iu mundësojë studiuesve dhe hulumtuesve shkencore që të kenë qasje në dokumentet arkivore nga Rahoveci.

- Me datë: 21.03.2022 - Në shënim të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi orë letrare me krijues dhe nxënës të shkollave të mesme e filllore të Rahovecit. Në këtë orë letrare morën pjesë: Prof. Dr. Sabahajdin Cena, Blerta Nalli - Gashi, Hazir Luta, Milazim Bajraj, Hysen Berisha, Valbona Hoti dhe disa krijues të rinj, paraqitën disa krijime artistike të tyre dhe të autorëve të ndryshëm. Për nder të Ditës Botërore të Poezisë disa autorët dhuruan Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" përmbledhje me poezi e romane si: Hysen Berisha "Arba" 4 ekzemplar po ashtu përmbledhje poezish me titull "Jetë valixhesh" 5 ekzemplar, Grup autorësh "Djepi i Lirisë" (Antologji) 5 ekzemplar, Shani Hoti "Ditar nga burgu" 2 ekzemplar si dhe Valbona Hoti "Unë prapë jetoj" 9 ekzemplar.
- Me datë: 28.03.2022 - Në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" u mbajt solo koncerti i kitaristit Elbasan Kryeziu me të cilën promovuan disa muzikantë.

❖ Pasurimi i fondit librar: 89 ekzemplar.

Dhuratë nga Kryetari i Komunës me 2 tituj 11 ekzemplarë.

Dhuratë nga Autori Sali Bytyqi me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Bajram Bekteshi me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Biblioteka Ibrahim Rugova me 1 tituj 1 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Valbona Hoti me 1 tituj 9 ekzemplar.

Dhuratë nga Grup autorësh me 1 tituj 5 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Hysen Berisha me 2 tituj 9 ekzemplar.

Dhuratë nga Autori Shani Hoti me 1 tituj 2 ekzemplar.

Dhurat nga Autori Fahri Xharra me 1 tituj 6 ekzemplar

Dhurat nga Autori Gëzim Ajgeraj me 18 tituj 27 ekzemplar

Dhurat nga Autori Rexhep .F. Morina me 1 tituj 3 ekzemplar

Dhurat nga Autori Ragip Ballata me 4 tituj 6 ekzemplar

Fondi total i librave në biblioteka: 25,323 ekzemplar.

❖ Sektori i huazimit të librit:

Janë regjistruar: Anëtar 449, Sh.Filllore 359, Sh.Mesme 43, Student 23, Të tjerë 24.

Djem 171, Vajza 278.

Me pagesë 438, Falas 11.

Shërbime me libra: 2339, Djem 934, Vajza 1405.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 159 përdorues.

❖ **Fondi total**

Fondi total i bibliotekës komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec është: 19.940 libra.

- Në vazhdimë janë parqitur në formë tabelore sektori i huazimit të librave për periudhën Janar- Qershor 2022

Anëtarësis dhe libra të lexuara në bibliotekë për muajin Janar - Qershor

Muaji	Anëtar	Me pagesë	Falas	Libra të lexuar	Djem	Vajza
Janar	165	161	4	602	208	394
Shkurt	65	63	2	326	126	200
Mars	53	53	0	391	156	235
Prill	80	77	3	387	182	205
Maj	53	51	2	345	136	209
Qershor	33	33	0	288	126	162
Gjithsej	449	438	11	2339	934	1405

Tabela e lexuesve për muajin Janar - Qershor

Muaji	Shkolla Fillore	Shkolla e Mesme	Studentët	Të tjerët	Djem	Vajza	Gjithsej
Janar	135	21	2	7	62	103	165
Shkurt	55	5	1	4	33	32	65
Mars	36	3	12	2	12	41	53
Prill	71	3	1	5	35	45	80
Maj	39	7	4	3	14	39	53
Qershor	23	4	3	3	15	18	33
Gjithsej	359	43	23	24	171	278	449

PALESTRA SPORTIVE “MIZAHIR ISMA”

Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars në palestrën sportive “Mizahir Isma” janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, si nga klubet të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar, ndër aktivitetet tjera janë:

Aktivitetet për muajin Janar-Mars

Klubi Basketbollistik “KB – Rahoveci”, garon në dy kompeticione garuese në Superligën e Basketbollit dhe Ligën Unike Kombëtare. Në Superligën e Kosovës si ekip nikoqir ka zhvilluar 7 (shtatë) ndeshje, ndërsa në Ligën Unike ka zhvilluar 4 (katër) ndeshje zyrtare.

Klubi basketbollistik “KB-Rahoveci”, si vendas në palestër ka zhvilluar 3 (tri) ndeshje zyrtare.

Klubi Basketbollistik “KB-Rahoveci”, për grupmoshat U-16 si vendas ka zhvilluar 5 (pesë) ndeshje zyrtare.

Klubi Basketbollistik “KB-Rahoveci”, për grupmoshat U-18 si vendas ka zhvilluar 1 (një) ndeshje zyrtare.

Klubi Hendbollistik “KH-Rahoveci”, garon në Superligën e Hendbollit të Kosoës në muajt janar, shkurt, mars ka zhvilluar 5 (pesë) ndeshje zyrtare në Palestër.

Klubi Hendbollistik KH-Rahoveci (Kadet) kanë zhvilluar 4 ndeshje zyrtare në kampionat.

Klubi i hendbollit ka siguruar pjesëmarrjen në garat evropiane është një sukses i konsiderueshëm për klubin tonë.

Klubi i Futsallit “FC-Rahoveci 2019”, garon në Superligën e Kosovës në Futsall dhe ambiciet kryesore të ekipës janë mbetja në Superligë edhe vitin e ardhshëm.

Gjatë muajve janar, shkurt, mars si nikoqir ka zhvilluar 2 (dy) ndeshje për kupën e Kosovës në Futsal.

Në kampionat vazhdon në muajt e ardhshëm.

Klubi i futsallit “KFS-Rahoveci”, garon në Ligën e Parë të Kosovës në Futsal, dhe qëllimi i klubit është të aktivizojë sa më shumë rini në sportin e futsallit.

Gjatë muajve janar, shkurt, mars ka zhvilluar 1 (një) ndeshje në kampionat dhe ndeshjet e radhës janë në muajt në vazhdim.

Klubi i Futsallit “KF-Burimi”, garon në Ligën e Parë të Kosovës në Futsall dhe për qëllim ka aktivizimin e rinis në sportin e futsallit ku dhe është viti i parë që merë pjesë në këto gara.

Gjatë muajve janar, shkurt, mars ka zhvilluar (dy) ndeshje në gara kampionale dhe ndeshjet e radhës janë në muajt në vazhdim.

Klubi Basketbollistik KB-Halit Hoxha ka zhvilluar 3 (tri) ndeshje zyrtare në kampionat në Basketboll për Grupmoshat U-12.

Është organizur kupa e Kosovës në palestër dhe pjesëmarrës kanë qenë 4 (katër) ekiye ku shkolla e basketbollit Halit Hoxha ka nxen vendin e 2 (dytë).

Zhvillimin e garave në Pin-Pong nga shoqata e pedagogëve të kulturës fizike pjesëmarrës kanë qenë shkollat fillore nga komuna e Rahovecit.

Turnir për nder ditës së Pavarësis 17 shkurt ku kanë qenë pjesëmarrës të gjitha ekipet nga komuna e Rahovecit. Turniri është zhvilluar në futboll të vogël, shah dhe volejboll.

PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-mars 2022 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Rahovec,

Qershor, 2022

